



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2021

VENDIM
Nr. 566, datë 02.12.2021

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 90/3 e 94/1 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR ELBASAN

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, Artan Jahollari, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: Rishikim vendimi.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LEZHË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Ardit Kuka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Nenet 78/1-22 e 278/1 dhe 84 i Kodit Penal.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Nertila Kape, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}; Akuza: Kryerja e veprave penale të parashikuara nga nenet 78/2-22 e e 278/1 dhe neni 305/b/1 të Kodit Penal.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Xhevdet Lika, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen penale me të

pandehur: {...}, {...}; Akuza: Kryerja e veprave penale të parashikuara nga nenet 79/dh e 25 e 278/1 dhe neni 300/1 të Kodit Penal.

4. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Alda Sadiku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen penale me të pandehur: {...}dhe {...}; Akuza: Parashikuar nga nenet 140-25 i Kodit Penal.

5. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Aurel Arapi dhe Olti Skrame, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen penale me të pandehur: {...} dhe {...}; Akuza: Kryerja e veprës penale e parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Aulon Pashaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen penale me të pandehur: {...}: Akuza: “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, parashikuar nga 100/2 i Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KRUIJË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Artan Çupi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale me të pandehur: {...}: Akuza: Neni 79/c i Kodit Penal.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË GJIROKASTËR

1. Gjyqtarja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, Ema Shaholli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, çështjen civile me Paditës: {...}; E paditur: Drejtoria Rajonale e Agjensisë së Kadastrës, Gjirokastër; Objekti: Të detyrohet organi publik Drejtoria Rajonale e Agjensisë së Kadastrës, Gjirokastër, të kryejë veprimin administrativ për të bërë regjistrimin fillestar dhe pajisur paditësat e trashëgimtarët e tjerë të trashëgimlënësës {...} dhe {...} me dokument pronësie kartelë pronësie dhe hartë.

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, Valdete Hoxha dhe Genti Shala, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}, etj.; Akuza: “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve”.

2. Gjyqtaret e Gjykatës së Apelit Tiranë, Edlira Petri dhe Elona Toro, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}; Akuza: “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve”; “Mosbindje ndaj urdhrimit të punonjësit të policisë së rendit publik”.

GJYKATA E APELIT VLORË

1. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës së Apelit Vlorë, për caktim gjyqtari, si vijon:

- 1.1 Kërkesës nr. 854 prot., datë 12.11.2020 dhe nr. 772 prot., datë 14.10.2021, për caktim gjyqtari në çështjen gjyqësore, që u përket palëve, paditës Sokol Ngresi etj, e paditur {...}, me objekt “Shpërblim dëmi” .;
- 1.2 Kërkesës nr. 835 prot., datë 04.11.2021 për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjes gjyqësore që u përket palëve, paditës {...} etj, e paditur {...} , person i tretë {...}, me objekt “Shpërblim dëmi”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Enton Dhimitri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me: Kërkesa me objekt “Përjashtim gjyqtari”.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Miranda Andoni, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen civile me Paditës: {...}; I paditur: {...}; Objekti: Përjashtim nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet/pagesat e ekspertëve. Detyrimin e të paditurit të dëmshpërblejë paditësat për dëmin pasuror dhe jopasuror të pësuar nga vdekja e nënës së tyre Liljana Rukaj.

4. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Irena Brahimi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; I pandehur: {...}; Akuza: Dhunë në familje, të parashikuar nga neni 130/a-2 të Kodit Penal.

5. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Sokol Pina, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; Persona në hetim: {...}, etj.; Objekti: “Pushim i çështjes penale nr.676/2018, regjistruar për veprat penale të “Ekspertimit të rremë”, “Shpërdorimit të detyrës” dhe “Pengimit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore”, parashikuar nga nenet 309, 248 dhe 320 të Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR